



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 374 Prot

Gjirokastrë, më 04.03. 2025

MIRATOI
REKTORI

Prof. dr. Jahor **CANA**



Lënda: Hapet thirrja për shkrim projekt propozimesh në kuadër të programit Interreg IPA Greqi-Shqipëri.

Në kuadër të Programit Interreg IPA Greqi- Shqipëri është hapur thirrja e re për projekt propozime, si më poshtë vijon:

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	Interreg IPA Greqi- Shqipëri	7 prill 2025

Programi Interreg "Greqi-Shqipëri" mbështet bashkëpunimin midis dy shteteve, si një mënyrë për të bashkuar forcat me qëllim zhvillimin e rajonit kufitar, për të arritur suksese dhe përfitime për të dyja vendet.

Prioritetet kryesore të kësaj thirrjeje janë si më poshtë vijon:

1. Një rajon ndërkufitar Greqi-Shqipëri më i gjelbër.
 - Promovimi i tranzicionit drejt një ekonomie qarkulluese dhe efikase.
 - Nxitja e mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe infrastrukturës së gjelbër duke përfshirë zonat urbane, si dhe reduktimi i të gjitha formave të ndotjes.
 - Promovimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë duke marrë parasysh qasjet e bazuara në ekosistemin.
 - Promovimi i aksesit të ujit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit.

2. Një rajon ndërkufitar më i aksesueshëm Greqi-Shqipëri.
 - Zhvillimi dhe përmirësimi i një sistemi të qëndrueshëm, inteligjent dhe ndërmodal të lëvizshmërisë kombëtare, rajonale dhe lokale, i aftë për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike, duke përfshirë përmirësimin e aksesit në rrjetin TEN-T dhe lëvizshmërinë ndërkufitare.

3. Një rajon ndërkufitar Greqi-Shqipëri i qëndrueshëm nga ana ekonomike dhe sociale.
 - Sigurimi i aksesit të barabartë në kujdesin shëndetësor dhe nxitja e qëndrueshmërisë së sistemeve shëndetësore, përfshirë kujdesin parësor, dhe promovimi i kalimit nga kujdesi institucional në kujdesin e bazuar në familje dhe komunitet
 - Rritja e rolit të kulturës dhe turizmit të qëndrueshëm në zhvillimin ekonomik, përfshirjen sociale dhe inovacionin social.

Thirrjet, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin e Interreg IPA Greece-Albania: (<https://greece-albania.eu/call/announcement-of-stage-b-of-the-1st-call-for-common-project-proposals-under-the-interreg-vi-a-ipa-cbc-greece-albania-2021-2027/>)

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

Zv. Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor

Prof.asoc. Merita Isaraj

